



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 20591 Prot.

Lezhë, më 03.12. 2025

VENDIM

Nr. 105, Datë 26. 11. 2025

**PËR DHËNIEN E DAKORDËSISË PËR VIJIMIN E PROCEDURAVE PËR  
HEQJEN NGA FONDI PYJOR KOMBËTAR TË SIPËRFAQES PYJORE NË  
PRONËSI TË BASHKISË, PËR KRYERJEN E AKTIVITETIT MINERAR NË  
OBJEKTIN GJOBARDHAJ, NGA SHOQËRIA "GJONI" SHPK**

Bazuar në Ligjin nr. 139, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Ligjin nr. 107/2014, datë 31.7.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", në Ligjin nr. 57/2020, datë 30.4.2020 "Për Pyjet", në VKM-në nr.888, datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", VKM-në nr. 559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", udhëzimin Nr.1, datë 26.01.2017 të Ministrit Mjedisit, "Për mbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullës kombëtar" pas shqyrtimit të dokumentacionit, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

**Vendosi:**

1. Të shprehë dakordësinë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor kombëtar sipërfaqen prej **6.775 ha** pyll në pronësi të Bashkisë, sipas raportit tekniko ekonomik bashkangjitur.
2. Sipërfaqja që do të hiqet nga fondi pyjor kombëtar detajohet si më poshtë:
  - **3.83 ha** pyll në ngastrën pyjore **103**, ekonomia pyjore "Brinjat e Kreshtës".
  - **2.85 ha** pyll në ngastrën pyjore **17**, ekonomia pyjore "Brinjat e Kreshtës".
  - **0.095 ha** pyll në ngastrën pyjore **18a**, ekonomia pyjore "Brinjat e Kreshtës".

3. Rehabilitimi i sipërfaqes pyjore të dëmtuar jashtë pjesës ku kryhet aktiviteti, bëhet nga shoqëria "GJONI" sh.p.k, sipas marrëveshjes së dakordësuar me Bashkinë, pasi të miratohet heqja nga fondi pyjor.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015.

**SEKRETARI  
FLORIDA ÇUNAJ**



**KRYETARI  
NDUE LULI**



Nr. 20581/1 prot

Dt: 12.12.25



KcB

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË  
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1191/14 Prot.

Lezhë, më 11.12.2025

**Lënda: Konfirmim vendimi**

**KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË**

**Për dijëni: KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË**

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit nr.107, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar, nenin 54 të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, ligjin nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, ligjin nr.57/2020 "Për Pyjet", ligjin nr.10304, datë 15.07.2010 "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, VKM-në nr.433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish komunave/bashkive" i ndryshuar, VKM-në nr.888, datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", VKM-në nr.559, datë 29.7.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike dhe prodhimet drusore e jodrusore pyjore, si dhe mënyrën e procedurës së mbledhjes së tyre" i ndryshuar, si dhe në Udhëzimin nr.1, datë 26.01.2017, të Ministrit të Mjedisit "Për mbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullor kombëtar", konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr.105, datë 26.11.2025 të këshillit të bashkisë Lezhë "Për dhënie e dakordësisë për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor kombëtar të sipërfaqes pyjore në pronësi të bashkisë, për kryerjen e aktivitetit minerar në objektin Gjobardhaj, nga shoqëria "Gjoni"Shpk.

PREFEKTI

Taulant MALSHI

